

V E N D I M
Nr. 28, datë 19.3.1999

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Hilmi Dakli,	Anëtar i “““
Zija Vuci,	Anëtar i “““
Hajredin Fuga,	Anëtar i “““
Bardha Selenica,	Anëtare e “““
Kujtim Puto,	Anëtar i “““
Kristofor Peçi,	Anëtar i “““
Sokol Sadushi,	Anëtar i “““
Alfred Karamuço,	Anëtar i “““

Me sekretare Arbenka Lalica e Drita Filto, më datat 26.2.1999 dhe 15.3.1999, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura kërkesën me nr.15 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: SALIKO RONDO, i përfaqësuar nga avokat Ermir Dobjani.

O B J E K T I: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.250, datë 25.11.1998 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Kasacionit.

Kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe:

- për parregullsi të administratës gjyqësore rekursi ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, nuk i është dërguar për shqyrtim Gjykatës së Kasacionit, e për rrjedhim kjo gjykatë çështjen e gjykoi mbi rekursin e të pandehurit tjetër Ermal Cani e jo edhe të kërkuesit;

- edhe pse avokati provoi se rekursi ishte bërë brenda afatit, Kolegji Penal nuk e shtyu çështjen, me qëllim që të krijonte mundësinë e shqyrtimit të rekursit;

- avokati i kërkuesit ka marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes nga Kolegji Penal dhe ka kërkuar pafajësi, por Kolegji ka shqyrtuar çështjen duke mos pasur në konsideratë shkaqet e parashtruara në rekurs;

- në vendim bëhet fjalë vetëm për uljen e masës së dënimit të kërkuesit duke e cilësuar këtë si bashkëpunëtor në krim, pa u dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura në rekurs e mbrojtje.

GJYKATA KUSHTETUESE,

Pasi dëgjoi shpjegimet e përfaqësuesit të palës kërkuese dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Gjykata e Rrethit Tiranë me vendimin nr.412, datë 20.5.1998 ka deklaruar fajtor kërkuesin Saliko Rondo për veprën penale të vjedhjes me armë në bashkëpunim dhe në bazë të nenit 140-25 të Kodit Penal e ka dënuar me 15 vjet heqje të lirisë. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr.233, datë 14.7.1998.

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit ka bërë rekurs veç njërit prej të gjykuarve të tjerë (Ermal Cani) edhe kërkuesi, duke e paraqitur atë sipas rregullave në kryesekretarinë e Gjykatës së Apelit, brenda afatit ligjor në 30.7.1998. Në rekurs janë ngritur një sërë problemesh me karakter ligjor, duke u pretenduar për pafajësi.

Kolegji Penal i Gjykatës së Kasacionit në datën 25.11.1998 ka shqyrtuar çështjen mbi rekursin e të pandehurit Ermal Cani. Në seancë gjyqësore ka marrë pjesë edhe avokati i kërkuesit, i cili pasi ka pretenduar se ka bërë rekurs brenda afatit ligjor, i ka dorëzuar një kopje të tij, ku ishte dhe shënimi përkatës i dorëzimit në sekretarinë e Gjykatës së Apelit. Edhe pse u vu përballë

një fakti të tillë, Kolegji Penal ka vazhduar shqyrtimin e çështjes mbi bazën e rekursit të Ermal Canit, duke dëgjuar njëkohësisht edhe pretendimet e mbrojtësit të kërkuarit.

Në përfundim Kolegji vendosi t'i japë pafajësi Ermal Canit, ndërsa kërkuarit i ul masën e dënimit nga 15 në 10 vjet heqje të lirisë, me të vetmin arsyetim se merr parasysh rolin e tij në bashkëpunimin në krim.

Gjykata Kushtetuese arrin në konkluzionin se procesi gjyqësor i zhvilluar nga Kolegji Penal i Gjykatës së Kasacionit, përse i përket kërkuarit Saliko Rondo, është i parregullt e për pasojë ai duhet të shfuqizohet si antikushtetues.

Së pari, është shkelur e drejta e ankimit ndaj vendimeve gjyqësore, si një e drejtë kushtetuese e parashikuar si në dispozitat kryesore kushtetuese ashtu dhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë - neni 43. Dëgjimin nga ana e Kolegjit Penal vetëm të mbrojtësit të kërkuarit, Gjykata Kushtetuese nuk e konsideron si realizim në të gjithë gjerësinë e vet të drejtës kushtetuese të ankimit. Po t'i referohesh përmbajtjes së vendimit dhe mungesës totale në atë të argumenteve për rrëzimin e pretendimeve të Saliko Rondos, arrihet plotësisht në konkluzionin se edhe dëgjimi i mbrojtësit ka qenë tërësisht formal gjë që përbën cënim të drejtës së mbrojtjes. Madje në pjesën hyrëse të vendimit nuk janë pasqyruar si objekt i shqyrtimit gjyqësor, jo vetëm shkaqet, por dhe fakti i ushtrimit të rekursit nga ana e të lartpërmendurit.

Ulja që i ka bërë Kolegji Penal masës së dënimit që i kanë caktuar atij dy gjykatat e shkallëve të tjera nuk do të thotë se në këtë gjykim janë analizuar pretendimet ose problemet e ngritura nga i pandehuri dhe mbrojtësi i tij. Përkundrazi, ndryshimi i kësaj pjese të vendimit është diktuar nga nevoja për të harmonizuar masën e dënimit me shkallën e fajësisë së tij në kryerjen e krimit, e cila siç pranon Kolegji, ka qenë më e vogël në krahasim me atë të dy të pandehurve të tjerë.

Së dyti, në këtë proces Kolegji Penal i Gjykatës së Kasacionit ka shkelur një detyrim kushtetues që buron nga neni 142/1 i Kushtetutës (dhe që gjente sanksionim edhe në dispozitat kryesore kushtetuese) – atë që vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara.

Në vendimin nr.250, datë 25.11.1998 të Kolegjit Penal jo vetëm që nuk bëhet fjalë për rekursin e Saliko Rondos, por nga përmbajtja e tij nuk del se ç'ka pretenduar ai në rekurs dhe kryesorja nuk përmendet çfarë ka pranuar e rrëzuar gjykata.

Për më tepër, ndërsa kërkuari si në rekurs ashtu dhe në fjalën e mbrojtësit ka pretenduar për pafajësi, në vendim, në mënyrë krejt spontane, në një paragraf të vetëm, argumentohet vetëm ulja e masës së dënimit.

Në këto rrethana, vendimi nr.250, datë 25.11.1998 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë përse i përket të pandehurit Saliko Rondo, duhet të shpallet antikushtetues si rezultat i një procesi jo të rregullt gjyqësor dhe çështja duhet të shqyrtohet përsëri nga Kolegji Penal mbi bazën e rekursit të ndodhur në dosje.

PËR KËTO ARSYE;

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131 gërma “f” të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë si dhe nenit 45 të Ligjit nr.8373, datë 15.7.1998 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

Të shfuqizojë si antikushtetues vendimin nr.250, datë 25.11.1998 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Kasacionit, vetëm përse i përket të pandehurit Saliko Rondo.

Ky vendim është i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

MENDIMI I PAKICËS

Gjatë gjykimit doli se përfaqësuesi i ankuesit Saliko Rondo ka marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes pranë Gjykatës së Kasacionit, ka paraqitur në seancë një kopje të ankimit të bërë që nuk kishte qenë bashkëngjitur me dosjen, ka parashtruar para gjykatës verbalisht arsyet e ankimit, duke kërkuar përfundimisht deklarin të pafajshëm të të pandehurit. Vendimi i Gjykatës së Kasacionit e përmend shprehimisht kërkesën përfundimtare të mbrojtësit se kërkon pafajësinë.

Po në vendimin e kësaj gjykate bëhet fjalë për masën e dënimit, duke ia zbritur, çka do të thotë se i ka shqyrtuar materialet e çështjes. Në fakt në vendim thuhet se nga materialet hetimore dhe gjyqësore ka rezultuar se i dënuari Saliko Rondo me Ilir Zhulin dhe Shaban Malajn kanë rënë në marrëveshje për të grabitur; se Saliko Rondo ka siguruar refugjatët duke i ftuar në makinën që drejtonte Ermir Cani. Gjithnjë në vendim arsyetohet se në procesverbalin e mbajtur nga prokurori në prani të avokatit si dhe në seancë gjyqësore Shaban Malaj dhe Ilir Zhuli kanë dhënë shpjegime të vazhdueshme e të qarta për bashkëpunim në krim me Saliko Rondon. Në fund Gjykata e Kasacionit arsyeton se për këtë duke marrë parasysh rolin e tij në bashkëpunim në krim dhe masën e dënimit të caktuar për të pandehurit Shaban dhe Ilir si ekzekutorë, masa e dënimit për Salikon ka zbritur në 10 vjet burgim.

Të gjitha sa më sipër vërtetojnë se Gjykata e Kasacionit e ka patur parasysh edhe ankimin e këtij.

Për këto arsye kërkesa nuk duhej pranuar.

A N Ë T A R I
H. Dakli

Tiranë, më 19.3.1999

Nr. 15 i regjistrimit themeltar
Nr. 28 i vendimit